



# Zëri i Grave

## Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Janar 2013



Drejtoresha e RrGGK –së Igballe Rogova ndan përvojat e organizimit të grave në Kosovë me studentët nga universitetet italiane dhe austriake (f. 3).

Bashkohuni me ne!



**Fushata Globale One Billion Rising, në Prishtinë,**  
14 Shkurt 2013

**Mbledhja në baza dy mujore e RrGGK-së,**  
4 Shkurt 2013, 11-13,  
Hotel Sirius, Prishtinë



[Bashkangjituni në faqen & grupin e Facebook-ut](#)



[Bashkangjituni listës së dërgesave për e-Lajme](#)

Në këtë botim

[Fondi i Grave të Kosovës ndikon në rreth 5000 gra](#)

[Ku janë paratë për të drejtat e grave?](#)

[Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore, fondi vazhdon në 2013](#)

[Studenët mësojnë për organizimin e grave të Kosovës](#)

## Forca e Sigurisë boton sygjerime për integrimin e grave

*Praktikat më të mira dhe sygjerimet për integrimin e grave dhe komuniteteve në Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës është publikuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) më 16 janar 2013. Ministria në fjalë tashmë kishte promovuar barazinë gjinore duke u bazuar në marrëveshjet dhe zotimet ndërkombëtare dhe kombëtare, me aprovimin e [Politikave të të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore së bashku me një Plan Veprimi](#) gjatë vitit të kaluar.*

Ministria në fjalë promovoi studimin e saj më të ri në kampin Adem Jashari të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë. Ministri i MFSK-së Agim Çeku hapi ngjarjen.

Ndër folësit ishte Drejtoresha Ekzekutive e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGGK) Igballe Rogova e cila foli rreth bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe organizatave të sigurisë. Bashkëpunimi në mes të RrGGK dhe MFSK filloi dhjetë vjet më parë kur Agim Çeku, atëherë komandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), paraardhëse e FSK-së, priti një delegacion të RrGGK. Pas vizitës së RrGGK-së, TMK-ja formoi një Bord për Barazi Gjinore. Më vonë, në vitin 2009, kur TMK-ja u transformua në FSK, ata ftuan RrGGK-në të marrë pjesë në procesin e hartimit të Strategjisë së FSK-së për Barazi Gjinore. RrGGK kërkon të vazhdojë këtë bashkëpunim pozitiv, tha Rogova.

"Falë Kvinna till Kvinna-s, RrGGK më parë ka organizuar ligjerata mbi pozitën e grave në Kosovë, në bazat ushtarake të KFOR-it suedez [NATO]", ka thënë Rogova. Më tutje ajo ka ofruar mundësinë që RrGGK të sigurojë ligjerata të ngjashme për FSK-në në bazat e saj nëpër Kosovë.

Azemina Culum, Shefe e Zyrës për Çështje të Komuniteteve në MFSK dhe Flora Macula, Përfaqësuese e UN WOMEN ishin në mesin e folësve të tjerë të cilët morrën pjesë në ngjarje.



*Raporti i ri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës bën thirrje për gratë në FSK.*

## Fondi i Grave të Kosovës ndikon në rreth 5,000 gra, vazhdon në 2013

RrGGK themeloi Fondin e Grave të Kosovës në vitin 2012, mbështetur nga Kvinna till Kvinna, për të mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë. Fondi ka dëshmuar të jetë një sukses i madh, që ka ndikuar në jetën e rreth 5,000 grave dhe vajzave moshave, etnive dhe feve të ndryshme, të vendosura në mbarë Kosovën.

Në mes të periudhës Tetor dhe Dhjetor 2012, Fondi i ri ka mbështetur financiarisht 12 organizata anëtare të RrGGK, me gjithsej 10.209€. Këto organizata kanë ofruar edukim, mbështetje dhe këshillim për gratë dhe vajzat, duke kontribuar në shëndetin, arsimimin, pavarësimin, sigurinë dhe fuqizimin ekonomik të tyre. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës, anëtarët e RrGGK kanë rritur ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave për osteoporozën, shtatzëninë e paplanifikuar ose të padëshiruar, kancerin e gjirit, shqetësimet pas abortit dhe strategjinë e planifikimit familjar. Ato poashtu arritën tek të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe njëherit avokuan për të drejtat e tyre. Ato gjithashtu kërkuan për të parandaluar dhunën në familje dhe mbështetën organizatat e grave në promovimin e punës së tyre përmes mediave publike. Në kuadër të këtyre iniciativave, anëtarët e RrGGK u bashkërenditën me organizatat tjera jo-qeveritare, spitalet, klinikat shëndetësore, organet studentore dhe zyrtarë të qeverisjes vendore.

Duke u bazuar në këto arritje, Fondi i Grave të Kosovës i RrGGK-së do të vazhdojë ofrimin e granteve në vitin 2013 me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe Kvinna till Kvinna.



*Përmes Fondit të Grave të Kosovës, anëtarja e RrGGK Jeta-Vita testoi 243 gra pensioniste për osteoporozë, si dhe avokoi suksesshëm për mjekim pa pagesë për ato në nevojë. Ky ishte një nga 12 grantet e vogla të përkrahura nga Fondi i Grave të Kosovës që rezultojnë në ndryshime të mëdha për rreth 5,000 gra dhe vajza të profileve të ndryshme nëpër Kosovë në 2012.*

## AWID, KWN pyesin: Ku janë paratë për të drejtat e grave?

RrGGK në partneritet me Alter habitus - Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë, ka filluar kërkime rreth "Ku janë paratë për të drejtat e grave: një studim i rastit të Kosovës". Hulumtimi ka pranuar fonde nga Association for Women's Rights in Development (AWID), një organizatë e anëtarësimit e orientuar kah e ardhmja ndërkombëtare, multi-gjeneratëshe, feministe, kreative, e angazhuar për arritjen e barazisë gjinore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe të drejtave njerëzore të grave. RrGGK është anëtare e AWID.

Hulumtimi do të kontribuojë në objektivat më të gjera të RrGGK-së "për fuqizimin e rrejtit duke identifikuar tendencat e financimit që lidhen me të drejtat e grave". Në të njëjtën kohë, ajo do të synojë të rrisë kapacitetet kërkimore të feministeve të reja mbi çështjet e lidhura me fuqizimin ekonomik, si dhe njohuri të mëtejshme në lidhje me prioritetet aktuale dhe të ardhshme të financimit të donatorëve në Kosovë. Hulumtimi do të shqyrtojë gjendjen aktuale financiare të organizatave të grave në Kosovë, si dhe mbështetjen e donatorëve për të drejtat e grave.

Studimi i Rastit të Kosovës është pjesë e hulumtitit ndërkombëtar të AWID "Ku janë paratë për të drejtat e grave?", duke kontribuar në njohuritë dhe në një platformë të mundshme të avokimit që do të mund të mbështeste grupet tjera të grave ndërkombëtarisht. Idea për të bashkëpunuar me AWID për këtë hulumtim lindi nga konferenca ndërkombëtare e AWID mbi fuqizimin ekonomik të grave, e mbajtur në Stamboll në vitin 2012 dhe e ndjekur nga anëtarët e RrGGK. Gjetjet e këtij hulumtimi mund të sigurojnë një kuptim më të mirë se si të fuqizohen gratë dhe OJQ-të e grave në Kosovë dhe më gjerë. Së fundi, hulumtimi dhe rekomandimet e tij kanë potencial për të transformuar fuqizimin ekonomik të OJQ-ve të grave (dhe komunitetet që ato shërbejnë), veçanërisht organizatave të marginalizuara nga trendet aktuale të donatorëve.

**awid** women's rights

## Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore, Fondi i Grave të Kosovës vazhdojnë në 2013

Është vendosur që Fondi i Grave të Kosovës dhe Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore, të mbështetura nga RrGGK të vazhdojnë deri në dhjetor 2014 me mbështetje shtesë nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), në shumën prej 280.800€.

Fondet do të mbështesin grante të vogla që ofrohen për anëtare të RrGGK përmes Fondit të Grave të Kosovës, dhe punën e Grupeve të Avokimit për Barazi Gjinore (GABGj), që lidhen veçanërisht me rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset vendim-marrëse komunale.

Projekti synon të krijojë edhe pesë GABGj në komunat e reja, duke forcuar edhe 13 GABGj ekzistuese. GABGj bashkojnë gratë anëtare të kuvendit, përfaqësues të OSHC-ve, mekanizmat e barazisë gjinore



*Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore bashkojnë gra të profileve të ndryshme nga politika dhe shoqëria civile për të diskutuar çështje që pengojnë barazinë gjinore në nivel komunal dhe për të identifikuar zgjidhje.*

dhe avokatët e tjerë për barazi gjinore në nivel komunal (përfshirë edhe meshkujt). GABGj-të do të fokusohen në identifikimin e prioriteteve të grave para zgjedhjeve komunale, duke avokuar për këto prioritete dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen më të madhe të grave si kandidatë dhe votuese në zgjedhje.

Në të njëjtën kohë, RrGGK do të vazhdojë të mbështesë anëtarët e saj në avancimin e kapaciteteve të tyre ekzistuese për planifikim, mbledhje të fondeve dhe ndërmarrjes së nismave efektive avokuese përmes Fondit të Grave të Kosovës. Fondi ofron grante të vogla në shumë që variojnë nga 1.500 € në 3.000 €. Përkrahur nga ADA, RrGGK do të bëjë thirrje të hapura për dy raunde në vit, në 2013 dhe 2014, që anëtarët e RrGGK të dorëzojnë aplikimet për fonde. Datat do të publikohen përmes sesioneve të informimit dhe faqes së internetit të RrGGK.

## Studentët mësojnë organizimin e grave të Kosovës

Studentët nga Qendra Evropiane Ndër-Universitare për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim në Venecia, Itali kanë vizituar Kosovën që nga viti 2004. Niveli i tyre i studimeve postdiplomike të masterit në të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim përfshin një udhëtim në terren në një vend të post-konfliktit, në mënyrë që ata të vizitojnë Kosovën dhe të takojnë përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale, organizatat dhe shoqërinë civile. Ata diskutojnë çështjet e të drejtave të njeriut në mjedise post-konfliktuale. Poashtu në vizitë ishin edhe studentët e nivelit postdiplomik të masterit nga Universiteti i Vjenës në Programin e të Drejtave të Njeriut.

Gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, ata u takuan me Drejtoreshën Ekzekutive të RrGGK Igballe Rogova me 17 Janar. Studentët mësuën për historinë e krijimit të RrGGK-së, punën e saj dhe sfidat me të cilat është përballur gjatë viteve.

"Ky takim është një nga takimet më interesante që kemi ndjekur deri më tani në Kosovë" tha Güler Alkan, një studente turke.

Rogova iu tregoi studentëve histori në lidhje me zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë, të cilat mund të gjenden në raportin hulumtues të fundit të RrGGK-së [1325 fakte & Fabula](#). Studentët shtruan pyetje dhe morrën pjesë në diskutim.



*Studentët nga universitetet italiane dhe austriake mësojnë për organizimin e grave në Kosovë.*